

# ANALIZË

## TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE

QEVERITARE NË NIVEL KOMBËTAR DHE QASJA NË  
INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK LIDHUR ME  
PUNËN PROFESIONALE TË GAZETARËVE



SHKUP, SHTATOR 2024

*3HM*

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



# IMPRESUMI

---

## Titulli

Transparenca e institucioneve qeveritare në nivel kombëtar dhe qasja në informacionin publik lidhur me punën profesionale të gazetarëve

## Autorë

Anita Petrovska Rajković

## Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

## Projekti

Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe pavarësisë së mediave si shtyllë e demokracisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

## Përkthimi në shqip

Ferikan Iljazi

## Shtypi

Grafotroid

## Tirazhi

30

## Distancimi nga përgjegjësia

Publikimi është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Vetëm autori është përgjegjës për përmbajtjen e tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Shkup, shtator 2024



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



|                                                                                                                                  |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| HYRJE                                                                                                                            | 5  |
| 1. LIGJI PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACION ME KARAKTER PUBLIK                                                                     | 6  |
| 2. PËRVOJAT DHE SFIDAT E GAZETARËVE DHE ORGANIZATAVE CIVILE KUR PËRDORIN LIGJIN PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACION                 | 6  |
| 2.1 SHEMBUJ TË PRAKTIKËS GAZETARESKE                                                                                             | 7  |
| 2.2 AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK - ANKESA, DËNIME, PËRVOJA DHE SHEMBUJ  | 10 |
| 3. TRANSPARENCA AKTIVE E INSTITUCIONEVE                                                                                          | 13 |
| 4. PROBLEMET DHE SFIDAT MË TË MËDHA TË GAZETARËVE GJATË PËRDORIMIT TË LIGJIT PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACION ME KARAKTER PUBLIK | 16 |
| 5. PËRVOJA, ZGJIDHJET LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE NË VENDET E RAJONIT                                                             | 21 |
| 6. KONKLUZA DHE REKOMANDIME                                                                                                      | 23 |
| 7. LITERATURA E PËRDORUR                                                                                                         | 26 |

E drejta për qasje të lirë në informacion është e një rëndësie themelore për demokracinë në një vend, e cila kontribuon në një qytetari më të informuar dhe të angazhuar, promovon transparencën dhe llogaridhënien dhe siguron qasjen e publikut në informatat të cilat i posedojnë institucionet. Kontribuon në uljen e korrupsionit dhe parandalimin e shpërdorimit të pushtetit, si dhe qytetarëve ju mundëson që të kërkojnë përgjegjësi nga zyrtarët që drejtojnë institucionet.

Ligji për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik u miratua në shkurt të vitit 2006. Që atëherë, e deri më sot ka pësuar shtatë ndryshime, e fundit prej të cilave është në vitin 2019<sup>1</sup>.

Më 6 dhjetor 2023, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi një sërë konkluzionesh me të cilat organet e administratës shtetërore udhëzoheshin që sa më shpejt të sigurojnë qasje të lirë në informatat me karakter publik, me qëllim të rritjes së transparencës dhe qasjes në informatat me karakter publik. Ato kanë të bëjnë me komunikimin funksional ndërmjet kërkuesve dhe poseduesve të informatave - ndër të tjera, adresat elektronike dhe numrat e telefonit të poseduesve të informatave të jenë të dukshme dhe të qasshme për qytetarët<sup>2</sup>.

Në raportin e Agjencisë për Mbrotjtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në informatat me Karakter Publik për punën në vitin 2023, të publikuar në mars të vitit 2024, thuhet se ndryshimet aktuale të zgjidhjes ligjore në thelb nuk kontribuojnë në ndryshimin e mentalitetit të kërkuesve, as atë të poseduesve të informatës.

Raporti i Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit për vitin 2024<sup>3</sup> thekson se Agjencia, përkundër burimeve të kufizuara për punë, vepron sipas ankesave të paraqitura dhe ndjek institucionet që kanë informatë. Në raport thuhet gjithashtu se kërkuesit e informacionit shprehin shqetësimin sepse arsyeja e refuzimit të qasjes në dokumente është se mbajtësit i referohen mbrotjtjes së të dhënave, pastaj sfidë është edhe vonesa dhe pritja e gjatë për marrjen e informacionit, e cila është gjithashtu një problem për gazetarët që punojnë me afate

---

1 Dekret për shpalljen e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatata me Karakter Publik [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2021\\_zakoni/2021\\_zakoni\\_alb/zakon\\_sloboden\\_pristap\\_101\\_2019\\_web.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2021_zakoni/2021_zakoni_alb/zakon_sloboden_pristap_101_2019_web.pdf)

2 Plani i Politikës së Qeverisjes së Mirë 2023 [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/plan\\_2023\\_public\\_final\\_mk.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/plan_2023_public_final_mk.pdf)

3 Raporti i Komisionit Evropian për sundimin e ligjit për vitin 2024 - Kapitulli për gjendjen e sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut <https://aspi.mk/новости/извештај-на-европската-комисија-за-вл/>

të shkurtra. Një vërejtje serioze është se administrata publike në praktikë nuk është mjaft përgjegjëse për ofrimin e qasjes në informacion.

Në vijim, dokumenti do të përpiket t'u përgjigjet disa pyetjeve: çfarë thotë ligji dhe çfarë tregon praktika kur bëhet fjalë për qasjen e lirë në informata me karakter publik, cila është transparenca aktive e institucioneve, me çfarë sfidash përballen kërkuesit e informacionit dhe cilat janë përvojat e vendeve të rajonit.

Në fund, dokumenti ofron rekomandime për tejkalimin e problemeve dhe përmirësimin e situatës, me çka do të sigurohej qasje e lire dhe në kohë deri tek informatat me karakter publik.

## **1. LIGJI PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK**

---

Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik rregullon kushtet, mënyrën dhe procedurën e ushtrimit të së drejtës së qasjes së lirë deri tek informacionime karakter publik, në dispozicion të poseduesve të informacionit, d.m.th. organeve të qeverisjes shtetërore dhe organeve të tjera dhe organizatave të definuara me ligj, organet e komunave, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarjet publike, personat juridikë dhe fizikë që ushtrojnë kompetenca publike të definuara me ligj dhe veprimtaritë me interes publik dhe partitë politike. (në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve).

Ky ligj rregullon gjithashtu përjashtimet nga qasja e lirë në informacion, detyrimet e ndërmjetësit të informacionit, detyrat e poseduesve të informacionit, procedurat për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informacion, shpenzimet e ndërmjetësit të informacionit, statusin dhe kompetencat e Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacion, si dhe dispozitat penale për poseduesit e informacionit për mospërmbushje të detyrimeve të përcaktuara me ligj.

## **2. PËRVOJA DHE SFIDA TË GAZETARËVE DHE ORGANIZATAVE CIVILE GJATË PËRDORIMIT TË LIGJIT PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACION**

---

Zbatimi i vendimit ligjor për qasje të lirë në informata me karakter publik është subjekt i monitorimit nga organizatat joqeveritare dhe gazetarët, të cilët statistikisht janë kërkuesit më të shpeshtë të informacionit me karakter publik.

Një nga vërejtjet kryesore në raportin e sektorit joqeveritar, i cili prej disa vitesh monitoron organet e administratës shtetërore dhe Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, është se institucionet nuk u përgjigjen kërkesave të tyre të parashtruara në kohën më të shkurtër të mundshme, por në parim shfrytëzojnë afatin e përcaktuar me ligj.

Edhe organizata joqeveritare “Metamorfozis” thekson nevojën për kryerjen e procedurave të brendshme në institucione për dërgimin më të shpejtë të përgjigjeve tek aplikantët. Kjo do të thotë se zyrtari që është i ngarkuar për marrjen e kërkesave për informacion në institucion të caktuar, i raporton kërkesat tek personat përgjegjës në institucion, të cilët duhet të përgatisin përgjigjen dhe t’ia dorëzojnë atë zyrtarit, në mënyrë që ai t’i përgjigjet kërkuarit të informacionit në kohën më të shkurtër të mundshme.

Gazetarët që punojnë në redaksi investigative dhe e përdorin shpesh këtë mjet, flasin për përvojat e tyre negative. Ata thonë se në raste të rralla vendosin të anashkalojnë procedurën e gjatë dhe të kërkojnë mënyra më të shkurtra për të marrë informacionin – përmes burimeve të tyre në institucione apo informatorëve të tyre. Në këtë kuptim, ka indikacione dhe kërkesa për ndryshime ligjore në afatin efektiv për përgjigjen e kërkesave: nga 20 apo 30 ditë për dokumentacion më të gjerë, afati duhet të përgjysmohet në 10 deri në 15 ditë.

## **2.1. SHEMBUJ TË PRAKTIKËS GAZETARESKE**

---

### **Rasti 1 - REL / Lotaria Shtetërore**

Një gazetar nga Radio Evropa e Lirë paraqiti një kërkesë për qasje në informata me karakter publik deri tek shoqata aksionare Lotaria Shtetërore, e cila është plotësisht në pronësi të shtetit. Gazetari kërkoi informata për një kontratë qiraje për një objekt, për të cilin institucioni më parë kishte shpallje publike, por rezultati nuk u bë publik.

Institucioni i ka vënë në dukje gazetarit që pyetjet lidhur me temën t’i dërgojë në formën e një kërkesë për qasje të lirë në informacion me karakter publik, si dhe në një kërkesë të veçantë lidhur me kërkesën për inspektim të kontratës së qirasë.

I udhëhequr nga përvojat e mëparshme negative të përgjigjes në kohë të institucionit ndaj kërkesave të tij, ai arriti të marrë përgjigjen përmes një burimi nga një institucion tjetër.

Në ditën e fundit të afatit ligjor, që është edhe dita kur duhej të publikohej storja<sup>4</sup>, ka marrë njoftim nga institucioni se përgjigjet janë duke u përgatitur për t'ia dorëzuar atij, por gazetari e ka publikuar lajmin, pasi nuk ka marrë fare përgjigje për kërkesën për qasje të lirë në informata të karakterit publik.

Gjatë kontrollit të raportit vjetor të institucionit për kërkesat e parashtruara për qasje të lirë, shkruhet se nga gjithsej tri të dorëzuara, vetëm njërës i është përgjigjur, ndërsa tre të tjerat janë evidentuar si kërkesa pa përgjigje, që në fakt kanë qenë kërkesa të gazetarit.

## Rasti 2 - 360 gradë/NPRRSH “Bechtel dhe Enka”

Prapavia e rastit - Çështja ka të bëjë me kërkesën e portalit “360 Gradë” për qasje në kontratën ndërmjet Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore (NPRRSH) dhe kompanive Bechtel dhe Enka për ndërtimin e autostradave. Ndërmarrja Publike ka refuzuar thuajse pa asnjë arsye, edhe pse e ka “miratuar” kërkesën, por është përgjigjur vetëm se kontrata nuk ka qenë informacion i karakterit publik. Media është ankuar tek Agjencia për Mbrojtje të së Drejtës për Qasje të Lirë Deri tek Informatat me Karakter Publik, e cila e detyroi Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore të jepte kontratën për ndërtimin e autostradave nga korridoret 8 dhe 10. Pavarësisht vendimit përfundimtar të autoritetit të nivelit të dytë, pronari i informacionit nuk pranoi të dorëzonte dokumentin me pretekstin se kontrata kishte një klauzolë që nuk mund të publikohej pa lejen e të gjithë nënshkruesve. Rezulton se marrëveshja është mbi ligjin<sup>5</sup>.

### Procedura dhe vendimi

- **Kërkesë:** Portali “360 Gradë” ka paraqitur një kërkesë në NPRRSH për qasje në kontratën me Bechtel dhe Enka, duke përfshirë një kopje të plotë të kontratës për ndërtimin e autostradave.
- **Kur:** Kërkesa është dorëzuar në shkurt 2024.
- **Afati për përgjigje:** Sipas ligjit, NPRRSH është dashur t'i përgjigjet kërkesës brenda 15 ditëve.

4 Lotaria shtetërore ka dhënë me qira një ish-lokal për dasma për 2.6 milionë euro <https://www.slobodnaevropa.mk/a/drzhavna-lotarija-zakupi-poraneshen-restoran-za-svadbi-za-2-6-milioni-evra/32642505.html>

5 (VIDEO) Gazetarët lehin, korridoret vazhdojnë <https://360stepeni.mk/video-novinarite-laot-koridorite-si-vrvat/>

- **Përgjigja e parë e NPRRSH:** NPRRSH i është përgjigjur kërkesës brenda 20 ditëve me plotësimin e pjesshëm të kërkesës. Një kopje e kontratës i është dorëzuar portalit, por disa nga detajet mbrohen si informata të ndjeshme komerciale.
- **Mangësi:** Përgjigja paraprake nuk përmbante të gjitha detajet dhe kushtet e kontratës, të cilat kufizonin kuptimin e plotë të përmbajtjes së kontratës.
- **Veprimet e portalit “360 Gradë”:** Portali “360 Gradë” ka paraqitur një ankesë pranë Agjencisë për Mbrojtjen e Lirisë së Qasjes në Informata me Karakter Publik, duke kërkuar versionin e plotë të kontratës, pa reduktime.
- **Reagimi i Agjencisë:** Agjencia e ka obliguar NPRRSH të shqyrtojë dhe korrigjojë vendimin dhe të sigurojë informacionin nga kontrata pa reduktime.
- **Reagim i NPRRSH dhe epilogu:** Pavarësisht vendimit përfundimtar të autoritetit të shkallës së dytë, mbajtësi i informacionit refuzon të japë dokumentin me pretekstin se në kontratë kishte një klauzolë që nuk mund të publikohej pa lejen e të gjitha palëve të nënshkuara. NPRRSH filloi rishikimin e kontratës dhe disa ndërhyrje shtesë u hoqën nga Agjencia, dhe kontrata e plotë u publikua në faqen e internetit të NPRRSH në qershor të vitit 2024.

### Rasti 3 - IRL – Elektranat e Maqedonisë së Veriut

Më 16 mars të vitit 2022, Laboratori i Reporterëve Hulumtues (IRL) dorëzoi katër kërkesa për qasje në informacione me karakter publik në Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore.

Dy vite pasi gazetarët e IRL kërkuan nga Elektranat e Maqedonisë së Veriut që të japin kontratat për blerjen e qymyrit dhe naftës për vitin 2021 dhe një pjesë të vitit 2022, EMV nuk iu përgjigj kërkesave për qasje në informata me karakter publik, duke refuzuar plotësisht qasjen, sepse informacioni përmbante sekrete biznesi që nuk kishin interes pulik që të ndaheshin me mediat.

Në vend të qasjes, EMV madje e paditi Agjencinë sepse vendosi në favor të IRL-së dhe mori vendim që Elektranat t'i jepnin të gjitha informacionet e kërkuara<sup>6</sup>.

6 EMV me padi në Gjykatën Administrative pengon publikimin e informacionit për qymyrin dhe naftën <https://irl.mk/esm-so-tuzhba-do-upraven-sud-sprechuva-ob-ava-na-informacii-za-aglenot-i-mazutot/>

## **2.2. AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK - ANKESA, DËNIME, PËRVOJA DHE SHEMBUJ**

---

Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik është themeluar në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 101/2019), dhe filloi punën në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga 25 dhjetori i vitit 2019 për emërimin e drejtorit të Agjencisë.

Detyra kryesore e Agjencisë është zbatimi, promovimi dhe mbrojtja e vazhdueshme e së drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve dhe lehtësimit të qasjes në informata me karakter publik.

Sipas ligjit, përveç detyrave të tjera, përgjegjësia e saj është të kujdeset për zbatimin e dispozitave të ligjit; të udhëheqë procedurën administrative dhe të vendosë për ankesat kundër vendimeve me të cilat poseduesit e informatës refuzojnë kërkesën për qasje në informata të kërkuarve, për të zhvilluar procedurën e kundërvajtjes përmes Komisionit për Kundërvajtje i cili vendos për kundërvajtje në përputhje me ligjin; të zhvillojë politika dhe japë mendime për propozimet e ligjeve që rregullojnë qasjen e lirë në informata, si dhe të përgatisë raport vjetor për punën e saj dhe t'ia dorëzojë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas të dhënave nga raporti i fundit vjetor i Agjencisë, gjatë vitit 2023<sup>7</sup>, procedura e ankimit pranë institucionit për ushtrimin e së drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik ka çuar në 453 raste.

Prej tyre 235 persona fizik, 190 organizata joqeveritare dhe 28 ankesa nga persona juridik.

Shumica e ankesave të parashtruara janë të drejtuara kundër institucioneve shtetërore në nivel qendror, komunave, ndërmarrjeve dhe institucioneve publike.

Shifrat e fundit tregojnë se nga data 01.01.2024 deri më 31.07.2024 në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik janë dorëzuar 216 ankesa.

---

7 Raporti vjetor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik për vitin 2023 <https://aspi.mk/wp-content/uploads/2024/04/godisen-izvestaj-2023-komplet.pdf>

Nga këto, 157 ankesa janë bërë për shkak të heshtjes së administratës, ndërsa pjesa tjetër kanë të bëjnë me pakënaqësi për përgjigjet e marra dhe aktet administrative të miratuara nga organi i shkallës së parë.

Statistikat e Agjencisë tregojnë se ankesat më të shumta janë për shkak të “heshtjes nga ana e autoriteteve”, pra kur poseduesit e informacionit nuk veprojnë sipas kërkesave të paraqitura brenda afateve të përcaktuara në ligj – 20 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës dhe një afat i zgjatur prej 30 ditësh, nëse kërkohet dokumentacion voluminoz.

## **Dënime dhe sanksione**

Në vitet e kaluara është zhvilluar procedim ndaj zyrtarëve për ndërmjetësim me informata, për mosveprimin ndaj vendimeve të Agjencisë.

Mirëpo, procedurat mbaruan pa gjoba të shqiptuara pasi zyrtarët kanë paraqitur dëshmi se kanë vepruar në përputhje me detyrimet e tyre sipas ligjit, përkatësisht se kanë njoftuar drejtuesit e institucionit – që disponojnë me informatat, për detyrimin për zbatimin e vendimit të Agjencisë.

Agjencia, gjatë trajnimeve që zhvillon për zyrtarët që kanë informacione, vazhdimisht përmend se detyrimi ligjor për t’iu përgjigjur kërkesave është i menjëhershëm. Megjithatë, mbajtësit e informacionit përdorin afatin maksimal prej 20 ditësh për t’iu përgjigjur kërkesës.

## **Shembuj nga praktika**

### **Rasti 1:**

|                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|--------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kërkesë:</b>                | Në korrik të vitit 2023, një gazetar i portalit “Reporter” ka paraqitur kërkesë në Ministrinë e Financave për raportin financiar të Ministrisë për vitin 2022. Kërkesa përfshinte detaje për shpenzimet, pagat dhe sponsorizimin e Ministrisë. Ministria kishte për obligim t’i përgjigjet kërkesës brenda 15 ditëve. |
| <b>Përgjigja e parë:</b>       | Ministria ia ka përcjellë përgjigjen gazetarit, por me lëshime dhe mangësi të theksuara. Në përgjigjen e dorëzuar në tetor të vitit 2023, mungojnë informacionet konkrete për shpenzime dhe paga, ndërsa një pjesë e të dhënave nuk kanë qenë funksionale apo nuk kanë qenë të plota.                                 |
| <b>Korrigjim i përgjigjes:</b> | Pas ankesës së gazetarit dhe ndërhyrjes së mëtejshme të Agjencisë, Ministria u përpoq të korrigjonte përgjigjen, por mangësi të theksuara ende ishin të pranishme.                                                                                                                                                    |

|                             |                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Veprimi i Agjencisë:</b> | Agjencia ka bërë shqyrtimin e rastit dhe ka konstatuar se Ministria nuk i ka përmbushur obligimet ligjore për zbulimin e plotë të informacionit. Në nëntor të vitit 2023, Agjencia vendosi sanksione ndaj Ministrisë për moszbatim të detyrimeve ligjore. |
| <b>Dënime dhe masa:</b>     | Dënimi përfshinte gjobë dhe urdhër që Ministria të publikonte raportet e nevojshme financiare brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. Ministria ishte gjithashtu e obliguar që raportin e kompletuar ta publikonte në ueb faqen e saj.                    |
| <b>Reagim i Ministrisë:</b> | Ministria e përmbushi urdhrin e Agjencisë dhe raportin e plotë e publikoi në ueb faqen e saj deri në fund të dhjetorit të vitit 2023.                                                                                                                     |

## **Rasti 2:**

Në nëntor të vitit 2023, një gazetar ka paraqitur një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë për raporte dhe të dhëna për tenderët publikë për pajisje mjekësore dhe ilaçe gjatë vitit 2022. Ministria duhej të përgjigjej brenda 15 ditëve.

|                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Përgjigja e parë</b>    | Ministria dërgoi një përgjigje të pjesshme në dhjetor të vitit 2023, e cila përfshinte vetëm një pjesë të të dhënave të tenderit dhe nuk përmbante të gjitha raportet e kërkuara për pajisjet mjekësore. Disa detaje të rëndësishme si çmimet dhe kushtet e tenderëve mungonin. |
| <b>Veprimi i Agjencisë</b> | Agjencia ka shqiptuar sanksion ndaj Ministrisë për shkak të mos përmbushjes në kohë dhe jo të plotë të kërkesës.                                                                                                                                                                |
| <b>Epilogu</b>             | Ministria e Shëndetësisë ka korrigjuar përgjigjen dhe ka dorëzuar të gjithë informacionin e kërkuar në janar të vitit 2024. Të gjitha të dhënat janë publikuar në ueb faqen e Ministrisë.                                                                                       |

## **Rasti 3:**

Në janar të vitit 2024, fondacioni arsimor ka paraqitur kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për raporte për shpërndarjen e mjeteve për projektet arsimore në dy vitet e fundit. Ministria është dashur të përgjigjet brenda 15 ditëve.

|                            |                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Përgjigja e parë</b>    | Ministria dërgoi një përgjigje të pjesshme në shkurt të vitit 2024, e cila përmbante shumën bazë të fondeve të alokuara, por nuk kishte detaje për projekte specifike dhe përfitues, gjë që kufizonte qasjen në mënyrën e shpërndarjes së fondeve. |
| <b>Veprimi I Agjencisë</b> | Agjencia ka shqiptuar sanksion ndaj Ministrisë për veprim sipas obligimeve ligjore.                                                                                                                                                                |
| <b>Epilogu</b>             | Ministria e korrigjoi përgjigjen dhe i dorëzoi të gjitha informacionet e detajuara në mars të vitit 2024. Raportet janë publikuar në ueb faqen e Ministrisë.                                                                                       |

Agjencia bën me dije se për herë të parë në vitin 2023 është bërë pagesa e detyruar përmes Drejtorisë së të Ardhurave Publike të tre vendimeve të Komisionit për Kundërvajtje.

Në një rast është shqiptuar gjobë prej 500 euro për shkak të mos caktimit të një zyrtari për ndërmjetësim lidhur me informatat me karakter publik dhe në dy raste është shqiptuar gjobë prej 250 euro për mosveprim ndaj vendimeve të Agjencisë. Agjencia ka zbatuar gjithsej 50 procedura shlyerjeje. Për mosrespektim të vendimeve të Komisionit për Kundërvajtje me të cilat është shqiptuar sanksion kundërvajtës, nuk është paraqitur asnjë padi në Gjykatën Administrative.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 57 procedura për shlyerje, për 33 prej të cilave është parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje, dhe për të cilat pas marrjes së informatave të kërkuara Komisioni për Kundërvajtje do të nxjerrë vendime përkatëse.

### **3. TRANSPARENCA AKTIVE E INSTITUCIONEVE**

Kapitulli "Transparenca aktive" është pjesa më pak e zbatuar e Strategjisë së Qeverisë për transparencë më të madhe të institucioneve, gjegjësisht shumica e masave të planifikuara për transparencë aktive as që kanë filluar.

Duke pasur parasysh se faqet e internetit janë burimi kryesor i informacionit zyrtar për punën e institucioneve, dhe janë një mjet për qasje më të shpejtë, më të lehtë dhe më të sigurt, shumica e treguesve të Indeksit të Hapjes i referohen faqeve të internetit si burim informacioni. Kjo do të thotë se institucionet duhet t'i publikojnë të dhënat edhe pa përdorur mekanizmat për qasje në informacione të natyrës publike.

Përkundër detyrimeve të marra, institucionet pjesërisht dhe në mënyrë josistematike i përditësuan dokumentet në ueb-faqet e tyre, pra nuk u krijua asnjë sistem se sa shpesh duhet të përditësohen dokumentet dhe informacionet e ndryshme.

Vitet e fundit, edhe pse është bërë progres, disa institucione ende nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm në faqet e tyre të internetit, pavarësisht kornizës ligjore.

## Poseduesit e informacionit

Agjencia ka regjistruar gjithsej 1457 mbajtës të informacioneve të karakterit publik.

Duke filluar nga viti 2023, Agjencia përgatiti udhëzime të detyrueshme për autoritetet publike për të përmirësuar transparencën e punës së tyre. Ky dokument përmban një listë të informacioneve që qytetarët i kërkojnë më shpesh. Dokumenti detyron autoritetet publike të publikojnë të gjitha informacionet që disponojnë, të sistemuara sipas kategorive, si dhe të publikojnë të gjitha përgjigjet e paraqitura për kërkesat për qasje të lirë në informata brenda 6 muajve.

Në periudhën nga 14 nëntori deri më 14 dhjetor 2023, Agjencia ka kryer monitorimin e 51 poseduesve të informatave nga 37 institucione, ndërsa 12 posedues e kanë përmbushur pjesërisht, për faktin se lidhjet e tyre janë zhvendosur në disa prej lidhjeve të ueb faqeve.

Më shpesh, informacioni i karakterit publik, lidhja me të, institucionet e zhvendosin në lidhje të tilla si: kontakti, marrëdhëniet me publikun, dhe sektore të ngjashme të faqeve të internetit. Agjencia beson se informacioni i pasistemuar krijon konfuzion tek qytetarët, pra informacioni është më i vështirë për t'u qasur.

Me zgjedhjen e qeverisë së re, disa ministri u transformuan, ndërsa në anën tjetër u krijuan të reja<sup>8</sup>. Në 100 ditët e fundit, ministrinë e qeverisë së re kanë hapur faqet zyrtare të internetit për komunikim me publikun, si dhe kontakte dhe informacione për punën e këtyre institucioneve.

Nga inspektimi rezulton se institucionet ende të padukshme për qytetarët janë Ministria e Sportit<sup>9</sup>, dhe Ministri pa portofol përgjegjës për integrimin dhe zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Romëve 2022-2030.

8 Përbërja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut <https://vlada.mk/sostav-na-vladata>

9 Ministria e Sportit <https://vlada.mk/node/36447>

Ministritë e tjera<sup>10</sup>, megjithatë publikojnë raportet vjetore për zbatimin e ligjit, por jo edhe kërkesat individuale të aplikantëve dhe përgjigjet e pyetjeve të tyre.

Indeksi i transparencës së Qeverisë, ministrive dhe organeve, i cili zbatohet nga organizata joqeveritare si “Metamorfozis”<sup>11</sup> dhe Qendra për Komunikim Qytetar, thekson mungesën e përputhshmërisë dhe transparencës ndërmjet institucioneve të ndryshme. Asnjë ministri e vendit nuk vlerësohet si shumë transparente sipas standardeve antikorrupsion, me një performancë mbi 80%.

Monitorimi është kryer edhe në 4 kategori të tjera të poseduesve, pra në 224 institucione. Në afatet e dhëna, 124 mbajtës, ose 55,36% nga 224, kanë dorëzuar pyetësorët e plotësuar:

- 
- 1. A ka publikuar uebfaqja informacionin** e detyrueshëm nga neni 10 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, duke vendosur një baner në një vend të dukshëm që të çon deri tek informacioni publik?

● **Banneri ishte i përfaqësuar në 54,98% të rasteve në ueb faqet e institucioneve.**

- 
- 2. A ka publikuar faqja në mënyrë anonime kërkesat për qasje në informacione** me karakter publik për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, së bashku me përgjigjet që i janë dorëzuar tashmë kërkuarit për t’u ripërdorur nga subjekte të tjera fizike dhe juridike pa paraqitur një kërkesë të re me të njëjtën përmbajtje?

● **Kjo është hallka më e dobët dhe ky informacion është më së paku i përfaqësuar me një përqindje prej vetëm 32%.**

- 
- 3. A e ka publikuar informacion publik të sistemuar sipas kategorive,** në përputhje me nenin 10 paragrafi 1 pika 22?

● **Vetëm 60.85% e institucioneve e kanë bërë këtë.**

---

---

10 Ministria për Vetëqeverisje Lokale <https://mls.gov.mk/mk/информации/слободен-пристап-до-информации-од-јавен-карактер>

11 Vlerësimi i qeverisjes së mirë të pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut - Fondacioni “Metamorfozis”. <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2024/06/mk-transparency-index-2024-policy-brief-finalna-logos-19.06.2024.pdf>

| Radhitja e ministrive sipas transparencës aktive |               |                                                                |                |                |
|--------------------------------------------------|---------------|----------------------------------------------------------------|----------------|----------------|
| Radhitja 2024                                    | Radhitja 2023 | Institucioni                                                   | Rezultati 2023 | Rezultati 2024 |
| 1                                                | 1             | Ministria e Mbrojtjes                                          | 100%           | 100%           |
| 2                                                | 4             | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale                        | 97,8%          | 95,7%          |
| 3                                                | 10            | Ministria e Punëve të Brendshme                                | 95,7%          | 87,5%          |
| 3                                                | 4             | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave    |                | 95,7%          |
| 5                                                | 6             | Ministria e Shëndetësisë                                       | 93,5%          | 91,3%          |
| 5                                                | 7             | Ministria e Vetëqeverisjes Lokale                              | 93,5%          | 90,9%          |
| 7                                                | 8             | Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor       | 91,7%          | 89,1%          |
| 7                                                | 8             | Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës            | 91,7%          | 89,1%          |
| 9                                                | 3             | Ministria e Financave                                          | 90,7%          | 98,1%          |
| 10                                               | 1             | Qeveria e RMV-së                                               | 87%            | 100%           |
| 11                                               | 11            | Ministria e Ekonomisë                                          | 82,6%          | 87%            |
| 12                                               | 16            | Ministria e Punëve të Jashtme                                  | 78,3%          | 67,4%          |
| 13                                               | 12            | Ministria e Arsimit dhe Shkencës                               | 76,1%          | 82,6%          |
| 14                                               | 13            | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve                           | 75%            | 80,4%          |
| 15                                               | 15            | Ministria e Kulturës                                           | 73,9%          | 71,1%          |
| 15                                               | 14            | Ministria e Drejtësisë                                         | 73,9%          | 79,2%          |
| 17                                               | 17            | Ministria e Sistemit Poliitik dhe Marrëdhënieve mes Bashkësive | 60,9%          | 52,2%          |

#### 4. PROBLEMET DHE SFIDAT MË TË MËDHA TË GAZETARËVE GJATË PËRDORIMIT TË LIGJIT PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK

Sfidat që lidhen me qasjen e plotë dhe të lirë në informacionin me karakter publik kufizojnë gazetarët dhe aftësinë e tyre për të informuar publikun në një mënyrë që është në interes të transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë pjesë, ne do të shikojmë disa nga problemet më të mëdha me të cilat përballen gazetarët, së bashku me shembuj dhe zgjidhje të mundshme.

#### Përvoja e gazetarit të “Meta.mk” - Ministria e Punëve të Brendshme

**Çfarë kanë kërkuar:** Gazetari nga “Meta.mk” ka dorëzuar kërkesë në Ministrinë e Punëve të

Brendshme (MPB) në shkurt të vitit 2024. Ai kërkoi të dhëna për numrin total të rasteve të korrupsionit në polici, numrin e punonjësve të policisë që janë dënuar apo shkarkuar për shkak të korrupsionit, si dhe informacion të detajuar për procedurat e brendshme që MPB-ja ndërmerr për trajtimin e korrupsionit.

Pas 30 ditësh pune, gazetari mori një përgjigje që përmbante vetëm të dhëna të përgjithshme për numrin e rasteve të korrupsionit, pa informacion në mënyrë të detajuar për masat dhe procedurat e marra. Gjithashtu, në përgjigje përmenden të dhënat e publikuara tashmë në raportin vjetor të MPB-së, të cilat nuk e përmbanin këtë informacion. Gazetari vuri në dukje se përgjigja ishte e paplotë dhe nuk përmbante të dhënat e kërkuara.

Në vend të afatit ligjor prej 20 ditësh pune, gazetari ka pritur 30 ditë pune për një përgjigje dhe pas pranimi të përgjigjes, është dashur të bëjë një kërkesë të re për informacion shtesë.

### **Përvoja e gazetarit të “Fokus” – Tema: Ndarja e tenderëve publik**

**Çfarë kanë kërkuar:** Në mars të vitit 2023, një gazetar i “Fokus” ka paraqitur një kërkesë në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, duke kërkuar informacion mbi procesin e dhënies së tenderëve publikë për ndërtimin e rrugëve gjatë dy viteve të mëparshme.

Gazetari kërkoi informacion specifik për kompanitë fituese, vlerën e kontratave, detajet e procedurave të tenderit.

Pas gati dy muaj, gazetari mori një përgjigje që përmbante vetëm informacione të paqarta për tenderët, pa informacion të detajuar për procedurat e tenderit apo kriteret në bazë të të cilave janë përzgjedhur kompanitë fituese. Ministria e ka theksuar volumin e kërkesës si arsye për përgjigjen e pjesshme dhe sugjeroi që gazetari të specifikojë më tej kërkesën.

Gazetari ka pritur 40 ditë pune për një përgjigje, që është dukshëm më gjatë se afati ligjor. Kjo shkaktoi një vonesë në botimin e tekstit dhe uli aktualitetin e tij.

### **Përvoja e gazetarit të “Portalb” - Tema: Menaxhimi i institucioneve shëndetësore publike**

**Çfarë kanë kërkuar:** Gazetari i “Portalb” ka paraqitur një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë në prill të vitit 2024, duke kërkuar informacione për shpenzimet e fondeve publike nga institucionet publike shëndetësore, përfshirë numrin e kontratave të lidhura me kompani private për furnizimin me pajisje mjekësore dhe medikamente.

Përgjigja nga Ministria ka mbërritur pas 25 ditësh pune dhe përmbante vetëm të dhëna të përgjithshme për shpenzimet totale të institucioneve shëndetësore, pa detaje konkrete për kontratat apo kompanitë me të cilat janë lidhur kontratat. Gazetari po ashtu shprehu keqardhje që përgjigja përmbante informacione që tashmë ishin publikuar në raportin vjetor të Ministrisë, por nuk ishin paraqitur në formë të kuptueshme.

Gazetari ka pritur 25 ditë për përgjigje, ndërsa është dashur të bëjë ankesë për shkak të informacioneve jo të plota. Procesi i apelimit zgjati edhe 30 ditë të tjera, gjë që vonoi ndjeshëm hulumtimin.

Nëse përpiqemi të kategorizojmë problemet me të cilat përballen gazetarët, mund t'i ndajmë ato në kategoritë e mëposhtme.

### 1. Afate të gjata për përgjigje dhe mosrespektim të afateve ligjore

Një nga problemet më të shpeshta me të cilat ballafaqohen gazetarët është vonesa në përgjigjet nga institucionet. Edhe pse ligji parashikon një përgjigje brenda 20 ditëve pune, shumë institucione nuk e respektojnë këtë afat. Vonesa shpesh e bën të pamundur që gazetarët të publikojnë informacionin në kohën e duhur, veçanërisht kur ato janë me interes të konsiderueshëm publik.

**Shembull:** Sipas hulumtimit të Qendrës për Komunikim Qytetarë, rreth 35% e kërkesave të paraqitura në vitin 2023 janë përgjigjur pas skadimit të afatit ligjor.

**Zgjidhje:** Zbatimi i sanksioneve më të rrepta për institucionet që nuk respektojnë afatin ligjor për përgjigje, duke përfshirë gjobat apo zbulimin publik të lëshimeve të tyre.

### 2. Përgjigje të paplota ose të parëndësishme

Shumë gazetarë raportojnë se marrin informacion jo të plotë ose të parëndësishëm nga institucionet, gjë që e ndërlikon raportimin e tyre. Në disa raste, institucionet përgjigjen me të dhëna të përgjithshme ose tashmë të disponueshme në vend të informacionit specifik që është kërkuar. Në disa raste, gazetarët raportuan se përgjigjet që morën nuk i plotësonin nevojat e tyre, gjë që i detyroi ata të parashtronin kërkesa shtesë ose të kërkonin informacionin përmes kanaleve të tjera.

**Shembull:** Në vitin 2024, një gazetarë që punonte në një tekst hulumtues mbi shpenzimin e fondeve publike mori një përgjigje nga Ministria e Financave me të dhëna të përgjithshme statistikore në vend të informacionit të detajuar për kontratat specifike.

**Zgjidhje:** Është e nevojshme të përmirësohet trajnimi i administratorëve për qasje të lirë në informacion me karakter publik, në mënyrë që të sigurohet se ata mund të njohin dhe japin informacionin e saktë të kërkuar nga gazetarët.

### 3. Refuzimi i kërkesave pa arsyetim adekuat

Disa institucione refuzojnë të japin informacion pa dhënë arsyetimin e duhur, gjë që është në kundërshtim me ligjin. Kjo paraqet një pengesë serioze për gazetarët, të cilët më pas duhet të shpenzojnë burime dhe kohë shtesë për të marrë të dhënat e nevojshme nëpërmjet ankesave.

**Shembull:** Në rastin e një kërkesë të dorëzuar në Agjencinë për Energjetikë, një gazetar mori një refuzim me arsyetimin se kërkesa ishte "shumë e gjerë", pa specifikuar se çfarë informacioni nuk mund të jepnin.

**Zgjidhje:** Është e nevojshme të krijohen mekanizma për një auditim të pavarur të kërkesave të refuzuara, duke siguruar kështu që institucionet do të japin arsye adekuate për çdo refuzim.

#### Formulime të përgjithshme (të përgjithësuara) për refuzimin e kërkesave:

1. "Informatat nuk janë të disponueshme për momentin."
2. „Po publikojmë informacione të pjesëshme që janë me interes publik, por jo të dhëna të plota."
3. „Ne nuk mund të japim informacion të detajuar për shkak të privatësisë ose interesave komerciale."
4. „Të dhënat e kërkuara nuk janë të disponueshme në dokumentacionin apo arkivin tonë."
5. „Kërkesa nuk mund të plotësohet në tërësi për kufizime teknike ose administrative."

Këta shembuj dhe formulime ilustrojnë se si institucionet ndonjëherë refuzojnë të japin informacione të plota ose përdorin përgjigje jo të plota që të shmangin kërkesat e mediave dhe organizatave civile.

### 4. Vështirësi në arritjen deri tek administratori për qasje të lirë në informata

Edhe pse institucionet kanë caktuar zyrtarë për qasje të lirë në informacion, arritja deri tek ta shpesh është e vështirë. Informacionet e kontaktit të këtyre zyrtarëve nuk janë gjithmonë të disponueshme për publikun ose, nga ana tjetër, janë të vështira për t'u gjetur në faqet e internetit të institucioneve. Për më tepër, komunikimi mund të bëhet edhe më pak efikas, duke pasur parasysh se shumë prej tyre janë të tejngarkuar me punë.

**Shembull:** Një gazetar që bën kërkime për sistemin shëndetësor ka më shumë se një javë që po përpiqet të kontaktojë zyrtarin për qasje të lirë në informacione në Ministrinë e Shëndetësisë, por pa sukses.

**Zgjidhje:** Duhet të sigurohet dukshmëri më e madhe e informacionit të kontaktit të administratorëve dhe duhet të merret parasysh mundësia e emërimit të më shumë zyrtarëve në institucionet me kërkesa të larta.

### 5. Mungesa e platformave dixhitale për paraqitjen e kërkesave

Megjithëse ligji lejon paraqitjen e kërkesave përmes postës elektronike, mungesa e një platforme të unifikuar dixhitale për paraqitjen dhe gjurmimin e kërkesave krijon pengesa shtesë.

nuk janë në gjendje të gjurmojnë statusin e kërkesës së tyre ose duhet të paraqesin të njëjtën kërkesë në institucione të ndryshme individualisht, gjë që në aspekt kohor dhe logjistik është e vështirë.

---

**Shembull:** HGazetari i portalit "Nezavisen" theksoi se për të marrë informacion të plotë për një rast është dashur të dorëzojë tre kërkesa të ndryshme në tre institucione të ndryshme.

**Zgjidhje:** Vendosja e një platforme kombëtare dixhitale për paraqitjen dhe monitorimin e kërkesave për qasje të lirë në informacion, e cila do të përmirësonte efikasitetin dhe transparencën e procesit.

---

## 6. Mungesa e kapaciteteve dhe burimeve në institucione

Shumë institucione ballafaqohen me mungesë të kapaciteteve dhe burimeve për të përpunuar në mënyrë adekuate kërkesat për qasje të lirë në informacion. Kjo shpesh rezulton në përgjigje të vonuara ose përgjigje me cilësi të dobët.

---

**Zgjidhje:** Është e nevojshme të shtohen burimet dhe personeli i institucioneve, veçanërisht në ato me një volum të madh kërkesash, për të siguruar një përpunim më efikas të kërkesave. Megjithatë, efikasiteti i qasjes në informacion nuk varet vetëm nga numri i punonjësve në institucion.

**Shembull:** Në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave janë vetëm 24 persona të ngarkuar për ndërmjetësimin e qasjes së lirë në informacion dhe sipas Indeksit të Hapjes së këtij institucioni, niveli i hapjes me 61,18% është nën mesataren e arritur nga Qeveria dhe ministrinë. Nga ana tjetër, Ministria e Mbrojtjes ka vetëm dy zyrtarë dhe është institucioni më i hapur sipas Indeksit rajonal me 89,72% përmbushje të treguesve.

---

## 7. Mbrojtje e pamjaftueshme ligjore për gazetarët

Edhe pse ligji parashikon procedura ankimore, gazetarët shpesh përballen me procese të gjata dhe të ndërlikuara kur kundërshtojnë vendimet e institucioneve. Mbrojtja e pamjaftueshme ligjore dhe procedurat e gjata i dekurajojnë gazetarët që të paraqesin ankesa, veçanërisht kur bëhet fjalë për informacione që janë me rëndësi kritike për punën e tyre.

---

**Shembull:** Një gazetar i "Fokus" ankohet se procesi i ankimit për një kërkesë të refuzuar ka zgjatur më shumë se gjashtë muaj, gjë që e ka bërë publikimin e informacionit të vjetëruar.

**Zgjidhje:** Është e nevojshme të përshpejtohen procedurat e ankimit dhe të krijohen gjykata të specializuara që merren me çështje që lidhen me qasjen e lirë në informacion.

---

## **5. PËRVOJAT, VENDIMET LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE NË VENDET E RAJONIT**

---

Ky seksion ilustron kornizën ligjore bazë dhe disa specifika për zbatimin e ligjit për qasje të lirë në informacion, karakterin e vendeve të rajonit, si dhe një paralele ku ndodhet Maqedonia në raport me këto vende.

Një shembull interesant për krahasim është Serbia si kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe Kroacia, e cila tashmë është pjesë e Unionit.

### **Serbia:**

Serbia prezantoi Ligjin për Qasje të Lirë në Informacion në vitin 2004. Ligji parashikon që çdokush të mos bëjë kërkesë për informacion dhe institucionet janë të detyruara të përgjigjen brenda 15 ditëve.

Zbatimi i ligjit në Serbi është subjekt i kritikave për shkak të transparencës së dobët të institucioneve. Edhe pse ligji është i mirëstrukturuar, shumë institucione publike ende shmangin publikimin e informacionit që u kërkohet. Sipas raportimeve të organizatave civile, institucionet shpesh keqpërdorin zgjatjet e lejuara të afateve të reagimit dhe rrallë japin përgjigje të plota dhe të kuptueshme. Një shembull është rasti i gazetarëve të organizatës BIRN (Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hulumtues) të cilët janë refuzuar disa herë për të marrë informacion për tenderët shtetërorë. Edhe pse nuk kishte ankesa, përgjigjet ishin ose të pjesshme ose ishin dorëzuar shumë vonë për të qenë të padobishme.

Serbia ka kornizë të ngjashme ligjore si e jona, por përballet me probleme më të mëdha në zbatim, sidomos për shkak të mospërputhjes së institucioneve dhe keqpërdorimit të shpeshtë të zgjatjes së afateve të reagimit, Maqedonia është në pozitë më të mirë sa i përket transparencës, pasi ka më shumë shembuj të institucioneve që refuzojnë plotësisht të ndajnë informacione, gjë që nuk është aq e zakonshme në Maqedoni.

### **Kroacia:**

Kroacia miratoi Ligjin për të drejtën e qasjes në informacion në vitin 2013, si pjesë e angazhimit të saj ndaj Bashkimit Evropian. Ligji parashikon që të gjitha institucionet publike duhet të ofrojnë qasje në informacion dhe se kërkesat duhet të trajtohen brenda 15 ditëve. Ligji është në përputhje me standardet evropiane dhe përfshin dispozita për sanksionimin e institucioneve që nuk e respektojnë atë.

Kroacia ka treguar një nivel të lartë transparence në lidhje me zbatimin e ligjit. Institucionet përgjithësisht respektojnë afatet dhe japin informacion në mënyrë të qartë dhe të ar-

ritshme. Sipas raporteve të Komisionit Evropian, Kroacia është ndër vendet më transparente në rajon.

Sfidat kryesore lidhen me kompleksitetin e kërkesave dhe kapacitetet e kufizuara të disa institucioneve, veçanërisht në nivel lokal. Megjithëse ligji zbatohet mirë në nivel kombëtar, ka vend për përmirësim në nivel lokal. Gazetarët në Kroaci në përgjithësi kanë një përvojë pozitive me ligjin.

Kroacia është shembull i zbatimit të suksesshëm të ligjit, me një nivel të lartë transparence dhe përgjigje të shpejtë ndaj kërkesave. Maqedonia mbetet prapa në këtë aspekt, veçanërisht në raport me cilësinë e përgjigjeve dhe zbatimin e vazhdueshëm. Maqedonia ka përkrahje më të zhvilluar nga sektori civil për monitorimin e ligjit, gjë që në Kroaci është më pak e theksuar.

### **Bosnja dhe Hercegovina:**

Vendi ka probleme të mëdha në zbatimin e ligjit, transparencë të ulët dhe refuzim të shpeshtë të kërkesave. Maqedonia është në një pozitë më të mirë, veçanërisht në nivel kombëtar. Ngjashëm me Maqedoninë, Bosnja dhe Hercegovina ka probleme me zbatimin në nivel lokal dhe me cilësinë e përgjigjeve.

### **Shqipëria:**

Shqipëria ka një kuadër ligjor të thjeshtuar, por zbatimi është shumë i kufizuar. Maqedonia është më e mirë për sa i përket transparencës dhe disponueshmërisë së informacionit. Ngjashëm me Maqedoninë, Shqipëria ka probleme me konsistencën në zbatimin e ligjit dhe monitorimin më të dobët të sektorit civil.

#### **Renditja e vendeve të rajonit sipas transparencës dhe zbatimit të ligjit për qasjen e lirë në informacion.**

##### **1. Kroacia**

Zbatim më i mirë i ligjit, nivel i lartë i transparencës dhe përgjigje të shpejta dhe të plota ndaj kërkesave.

##### **2. Serbia**

Kuadrë ligjor solid, por me probleme të shumta në zbatim, veçanërisht në lidhje me zvarritjen dhe refuzimin e kërkesave.

##### **3. Bosnje dhe Hercegovinë**

Transparencë e nivelit të ulët dhe probleme të shpeshta në zbatim, me qasje të kufizuara deri tek informacionet në nivel lokal.

##### **4. Shqipëria**

Më i dobëti për sa i përket zbatimit të ligjit, me qasje shumë të kufizuara në informacion dhe pak burime për monitorim.

Maqedonia është në mes të renditjes së vendeve të rajonit sipas transparencës dhe zbatimit të ligjit për qasje të lirë në informata. Edhe pse ekziston një kuadër i mirë ligjor dhe një sektor aktiv civil, zbatimi i ligjit dhe transparenca në institucione ende përballen me sfida të mëdha.

Krahasuar me Kroacinë, Maqedonia mbetet prapa për sa i përket konsistencës dhe cilësisë së përgjigjeve, ndërsa në raport me Serbinë është në pozitë më të mirë për shkak të frekuencës më të ulët të refuzimit të plotë të kërkesave.

## 6. KONKLUZA DHE REKOMANDIME

---

Për përmirësimin e situatës nevojiten masa konkrete që mundësojnë reagim më të shpejtë dhe më të saktë nga institucionet, administratorë më të trajnuar për qasje të lirë në informacion dhe mekanizma më efikase të ankesave. Vetëm me ndryshime të tilla gazetarët do të mund ta kryejnë më lehtë rolin e tyre si kontrollues të pushtetit dhe mbrojtës të interesit publik.

Në harkun kohor gati pesë vjeçar, sa është zbatuar Ligji për Qasje të Lirë në Informacion, nga ndryshimet e tij të fundit, një periudhë e mjaftueshme për këtë analizë, për të parë anët pozitive, si dhe për të përcaktuar mospërputhjet ose mangësitë e caktuara në dispozitat ligjore.

Për këtë qëllim, Agjencia ka dorëzuar propozimin për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione të Natyrës Publike, në Ministrinë e Drejtësisë si ministri kompetente.

Ndryshimet dhe shtesat kanë të bëjnë me seksionin me përjashtimeve, dispozitat penale, ndryshimet në formularin e Raportit Vjetor, si dhe shkurtimin e afateve për shqyrtimin e kërkesave për informacion me karakter publik.

Agjencia ofron ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në ligj me qëllim zbatimin më efektiv të interesit publik dhe mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, një nga karakteristikat themelore të një shoqërie moderne demokratike dhe një nga mjetet bazë kundër korrupsionit.

### Rekomandime të tjera të bëra nga gazetarët dhe organizatat qytetare janë:

- **Nevoja për fushata dhe edukim** të të gjithë qytetarëve për rëndësinë dhe qëllimin e Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik.
  - **Rritja e buxhetit për Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik** për ngritjen e vetëdijes dhe opinionit publik dhe njohurive rreth Ligjit për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik.
-

- **Trajnim i zyrtarëve të emëruar** nga poseduesit e informacionit dhe përditësim i vazhdueshëm i faqeve të internetit të institucioneve gjatë ndryshimeve.
- **Poseduesit e informacionit të japin informacion** të përditësuar për ushtrimin e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, duke publikuar kërkesat e përgjigjura, të krijojnë një seksion të veçantë në faqen e internetit me të gjitha të dhënat për ushtrimin e kësaj të drejte.
- **Rritja e dënimeve aktuale për kundërvajtje** për zyrtarin dhe poseduesin e informacionit që nuk jep përgjigje të plota ose refuzon t'i përgjigjet kërkesës.
- **Poseduesit e informacionit të mos e zgjasin dhe abuzojnë me afatin ligjor maksimal** prej 20 ditësh për t'iu përgjigjur kërkesave. Agjencia vlerëson se ekziston mundësia e shkurtimit të afatit për përgjigje, veçanërisht për kërkesat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.
- **Ndryshime ligjore për të reduktuar kohën** e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe reduktimin e tyre nga 20 në 10 ditë, dhe për kërkesat për dokumentacion më të gjerë nga 30 në 15 ditë.
- **Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative duhet të ndalojnë praktikën e trajtimit të padive nga autoritetet publike** dhe t'i refuzojnë ato si të palejueshme për të mbrojtur rolin e Agjencisë si autoritet dytësor në trajtimin dhe ushtrimin e së drejtës për akses të lirë në informacionin e një natyrës publike.
- **Sa i përket transparencës proaktive<sup>12</sup>, problemi është tek mosunifikimi i faqeve të GJLMV-së dhe ministrive.** Përkatësisht, analiza e bërë për përgatitjen e Strategjisë së Transparencës GJLMV (2019-2021) ka rezultuar në përfundimin se pothuajse secila prej tyre ka një dizajn të ndryshëm, i cili në vetvete do të paraqiste një sfidë për qytetarët, shoqatat e qytetarëve dhe mediat. Sfidat e dytë lidhet me mosrespektimin e nenit 10 të AMDQLIP-së dhe mospublikimin e informacionit në faqet e internetit të të gjitha ministrive.
- **Të dhënat mbi pronësinë dhe pronësinë e vërtetë të firmave duhet** të vihen plotësisht në dispozicion të publikut për të mundësuar përdorimin më të gjerë të tyre (p.sh. lidhja me të dhënat e pronës, aktgjykimet, etj.). Ka shembuj të suksesshëm të përdorimit të tillë të të dhënave në Francë, Mbretërinë e Bashkuar, Kenia, Malajzi, Ukrainë, etj.
- **Nëse diçka duhet dhënë si informacion publik duhet të vendoset nga administratorët e punësuar tek organi, jo nga zyrtarët.** Kur paraqitet një kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik, vendimi (nëse qasja do të lejohet apo jo) nuk duhet të merret nga zyrtari (ministri, drejtori, etj.), por nga nëpunësi administrativ që është caktuar si person zyrtar për të ndërmjetësuar të drejtën për qasje të lirë në informacion. Megjithatë, analizat në terren tregojnë se parimi i delegimit të autoritetit vendimmarrës ende nuk respektohet sa duhet. Kjo duhet të jetë

12 Plani i Gjashtë Kombëtar i Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur për periudhën 2024-2026 (PAK 6) <https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2024/02/6.-HOBO-Предлог-НАП-ПОВ-2024-2026-за-Влада.pdf>

prioritet në Strategjinë e re të Transparencës Dhjetor 2023 - Dhjetor 2026, pra pritjet që në të ardhmen zyrtarët të mos miratojnë kërkesat për qasje në informacione të karakterit publik dhe as të nënshkruajnë vendime, duke ulur kështu mundësinë e shpërdorimit të pushtetit vendimmarrës, por edhe të rreziqet e gabimeve.

---

## Rekomandime për gazetarët

### ● Formulimi i kërkesave:

Ndonjëherë, kërkesat janë shumë të përgjithshme ose të paqarta, duke i lejuar institucionet të përgjigjen në një mënyrë të padobishme.

Kërkesat e formuluar mirë, të cilat janë specifike dhe të synuara, mund të përmirësojnë efektivitetin e qasjes në informacion. Gjithashtu u jep autoriteteve më pak hapësirë për ta refuzuar atë në bazë të paqartësisë.

Kërkesa duhet të përmbajë formën në të cilin dëshironi të njiheni me informacionin e kërkuar (inspektim, transkript, fotokopje ose regjistrim elektronik). Por duhet të tregoni gjithashtu se si dëshironi që informacioni t'ju dorëzohet, me postë, me telefon, me faks, me e-mail, etj.

Duke pasur parasysh këtë, është e nevojshme që gazetarët t'i kushtojnë vëmendje mënyrës së paraqitjes së kërkesave, për të rritur mundësinë e marrjes së informacionit të dobishëm.

---

### ● Gazetarët duhet të bindin redaktorët dhe shefat se dorëzimi dhe përcjellja e qasjes në informacion nuk është humbje kohe, por në fakt është një pjesë e dobishme e aktivitetit gazetaresk. Aktualiteti i storjes nuk duhet të mbizotërojë mbi nevojën për të marrë informacion dhe të dhëna të sakta dhe të besueshme.

---

### ● Nëse nuk jeni të sigurt se ku duhet të dorëzohet kërkesa, ekziston mundësia që disa kërkesa të dorëzohen në tre ose më shumë institucione në të njëjtën kohë.

---

### ● Të dokumentohen (arkivohen) kërkesat nga gazetarët. Në këtë mënyrë do të mund të tregohet se kërkesa është dërguar, në rast se duhet të parashtrahet ankesë.

---

### ● Të shfaqet publikisht se një kërkesë është paraqitur nga gazetari: Nëse shkruhet ose transmetohet një lajm se kërkesa është dorëzuar, mund të bëhet presion ndaj institucionit publik që ta shqyrtojë dhe t'i përgjigjet kërkesës. Refuzimi për të dhënë informacion pas një kërkesë të paraqitur nga një gazetar është shpesh një storje më vete. Në këtë mënyrë, storja do të mbahet e gjallë pa prituri përgjigje.

---

## BIBLIOGRAFIA

---

1. [metamorphosis.org.mk](https://metamorphosis.org.mk) - Hulumtim dhe analiza të transparencës së institucioneve në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë indeksin e transparencës..
2. [vlada.mk](https://vlada.mk) - Strategjia e transparencës dhe dokumentet që lidhen me qasjen e lirë në informacion.
3. [aspi.mk](https://aspi.mk) - Raporte dhe dokumente lidhur me zbatimin e ligjit për qasje të lirë në informacion.
4. *Programi i punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2024. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. fq. 8, marrë nga: <https://cutt.ly/WKKSjQK>*.
5. [meta.mk](https://meta.mk) - Artikuj që lidhen me transparencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe përvojat e gazetarëve.
6. [fokus.mk](https://fokus.mk) - Artikuj që kanë të bëjnë me dhënien e tenderëve publikë dhe artikuj kërkimorë mbi temën e transparencës.
7. [portalb.mk](https://portalb.mk) - Artikujt që kanë të bëjnë me menaxhimin e institucioneve publike shëndetësore dhe shpenzimin e fondeve publike.
8. <https://www.ccc.org.mk/>
9. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale <https://mls.gov.mk/>.
10. Plani i Gjashtë Kombëtar i Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur për periudhën 2024-2026 (PAK 6) <https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2024/02/6.-HOBOPредлог-НАП-ПОВ-2024-2026-за-Влада.pdf>.
11. <https://www.slobodnaevropa.mk> Artikuj që lidhen me temën e transparencës
12. <https://360stepeni.mk> Artikuj që lidhen me temën e transparencës
13. <https://irl.mk> Artikuj që lidhen me temën e transparencës



**WWW.ZNM.ORG.MK**